

“Ekonomia në rrugë të mbarë”. Revista Monitor, nr.50/2003

Edhe për vitin e ardhshëm, ashtu si në vitet e mëparshme, dy institucionet kryesore vendimarrëse të vendit në fushën e ekonomisë dhe të financave, Qeveria e Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë, kanë arritur konsensusin për objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të vendit, përfshirë dhe atë që konsiderohet si bashkëjetesë e harmonizuar midis politikave fiskale dhe monetare. Për më tepër, ky proces ka qenë pjesë e një konsultimi konstruktiv me institucione të tilla si FMN dhe BB, duke bërë të mundur që edhe për vitin 2004 të arrihet një marrëveshje e re financiare me këto dy institucione.

Treguesit kryesorë makroekonomikë.

Treguesit kryesorë makroekonomikë.					
Treguesit e ekonomisë reale (në pike përqindjeje)					
Rritja PBB	7.8	6.5	4.5 - 5	6.0	6.0
ICK vjetor (mesatar)	0.0	3.1	5.2	2.3	3.0
PBB nominale (miliarde leke)	539.2	590.2	678	745	823
Treguesit fiskalë (në përqindje ndaj PBB)					
Deficiti fiskal	-8.9	-8.2	-6.9	-5.8	-4.8
Treguesit monetarë (në pikë përqindjeje)					
Rritja M3	12	19.9	7.0	9.5	10.6
Normat e interesit të BTh 3m	7.8	8.0	10.6	7.6	

Zhvillimet në cmimet e konsumit karakterizohen nga presione të ulta inflacioniste. Parashikimet tona tregojnë se objektivi i Bankës së Shqipërisë për inflacionin do të përmbushet gjatë vitit 2003. Në mungesë të fenomeneve *shock*, inflacioni duket se do jetë brenda kontrollit edhe për vitin 2004. Gjithashtu, pritjet e ekonomisë duket se flasin për një qëndrueshmëri në nivelin aktual të inflacionit. Raportet dhe struktura e likuiditetit në ekonomi duket se janë afër niveleve të tyre historike, ndërsa normat e interesit kanë patur tendencë rënëse gjatë vitit 2003. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë, në varësi të ecurisë së mëtejshme të treguesve monetarë dhe atyre të inflacionit, mund të shikojë mundësinë e një uljeje të mëtejshme të normave të interesit, në mbështetje të aktivitetit ekonomik ose të objektivit të inflacionit. Duke përgjithësuar analizën e tendencave aktuale, mund të themi se gjatë vitit 2004 normat e interesit do të jenë përgjithësisht të qëndrueshme, ose me tendencë rënëse.

Banka e Shqipërisë, do të jetë përsëri e pranishme në tregun valutor, për të penguar një mbiçmim të mëtejshëm të lekut. Duke analizuar zhvillimet e treguesve monetarë gjatë viteve të fundit, vëmë re se oferta e lekut (rritja e M2) në tregun e brendshëm ka qenë në rënie, si pasojë e mungesës së të ardhurave të privatizimit të qeverisë të cilat Banka e Shqipërisë i ka konvertuar në lekë duke hedhur likuiditet në treg. Oferta e reduktuar e lekut, së bashku me kërkesën e rritur për të (si pasojë normave të larta të interesit të aseteve financiare në lekë gjatë vitit 2003), kanë ushtruar presion për mbiçmimin e lekut gjatë vitit 2003.

Nevojat e bizneseve për huamarrje në mbështetje të bizneseve e tyre kanë treguar rritje në vitet e fundit. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2004. **Kredia për ekonominë gjatë vitit të ardhshëm është parashikuar të rritet me 16.5 miliardë lekë.** Krahasuar me

rritjen e tepricës së kredisë për vitin 2003, kjo rritje është rreth **3.6 miliardë lekë, ose 28 për qind, më e madhe.**

Rritja e kredisë në valutë supozohet të jetë rreth **14.5 miliardë lekë,** ose 88 përqind e rritjes totale të kredisë për ekonominë. Diferenca mes normave të interesave të kredisë në lekë ndaj atyre në valutë, mendohet të jetë një nga arsyet kryesore të rritjes së ngadaltë të kredisë në lekë. Gjithashtu, niveli i lartë i likuiditetit të sistemit bankar gjatë vitit 2003 duket se nuk ka ndikuar në rritje të tepricës së kredisë në lekë.

Rritja e parashikimit të rritjes së tepricës së kredisë për ekonominë për vitin e ardhshëm bazohet në tendencën në rritje të nevojave për financim të sektorit privat. **Ndërkohë, parashikimi për një rritje të ulët prej 2 miliardë lekë, ose 12 përqind e kredisë në lekë, mbështetet në normat e larta të interesave të kredidhënies në lekë krahasuar me ato në valutë.**

Supozimi i përafritit të normave të interesave të kredidhënies në lekë dhe në valutë, do të ndryshonte edhe parashikimet për rritjen e tepricës së kredisë në monedhat përkatëse në të ardhmen.

Viti 2004, parashikime në shifra

- Ruajtja e normës së inflacionit Brenda kufijve 2-4 për qind.
- Rritje ekonomike prej 6 për qind
- Kontrolli i huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së
- Normat e interesit parashikohen të jenë të qendrueshme ose me tendencë rënëse
- Depozitat në valutë pritet të kenë një rritje të konsiderueshme vjetore, prej rreth 18.2 përqind, ose 17.7 miliardë lekë, në fund të vitit 2004.
- Paraja jashtë bankave parashikohet të rritet me rreth 14.9 miliardë lekë gjatë vitit të ardhshëm. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare supozohet të luhatet rreth nivelit 28.0 përqind.
- Rritja e depozitave në lekë për vitin që vjen parashikohet 14.8 miliardë lekë ndërkohë që kërkesa e qeverisë dhe e sektorit privat për mjete monetare në lekë parashikohet 14.5 miliardë lekë.
- Gjatë vitit 2004, huamarrja e brendshme e qeverisë për mbulimin e deficitit buxhetor është parashikuar të jetë 22.6 miliardë lekë, ndërkohë që pjesa që pritet të përballohet nga të ardhurat nga privatizimi është rreth 2.8 miliardë lekë.
- Kredia për ekonominë gjatë vitit të ardhshëm është parashikuar të rritet me 16.5 miliardë lekë. Krahasuar me rritjen e tepricës së kredisë për vitin 2003, kjo rritje është rreth 3.6 miliardë lekë, ose 28 për qind, më e madhe.
- Rritja e kredisë në valutë supozohet të jetë rreth 14.5 miliardë lekë, ose 88 përqind e rritjes totale të kredisë për ekonominë.

Treguesit fiskalë në përqindje të PBB	2002	2003	2004
Të ardhurat buxhetore	22.8	23.5	24.4
Të ardhurat tatimore	19.0	20.1.0	20.7.0
Shpenzimet buxhetore	28.4	28.1	29.2
Deficiti i përgjithshëm buxhetor	6.2	4.6	4.7
Financimi i brendshëm i deficitit	3.2	2.9	3.1